

**AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
“SIMAS Group” sh.p.k.**

Sot, me date 21 Nentor 2022, une i neneshkruari:

- Z. Massimo Sirio, Shtetas Italian, lindur ne Torino, Itali me 15.05.1963 me atesi Z. Luciano, banues ne Torino, Itali, mbajtes i dokumentit te identitetit Pashaporte me numer: YA7764491, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Ne perputhje me Ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008, “Per tregetaret dhe Shoqerite Tregetare” (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723 date 3.5.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” (i ndryshuar) kemi vendosur te themelojme nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar te emeruar “SIMAS Group” sh.p.k (me poshte referuar si “Shoqeria”), duke neneshkruar kete Akt Themelimi, Aktiviteti i kesaj Shoqerie do te rregullohet nga Statuti i saj, i cili eshte pjese perberese e ketij Akti Themelimi.

**Neni 1**

Emri i Shoqerise eshte “SIMAS Group” sh.p.k.

**Neni 2**

Selia e Shoqerise ndodhet ne Adresen: “Nj. A. 14, Rr. Stefan Shundi, Zone Kadastrale 3866, Nr. Pas. 214/321+1-3, Tirane”.

Shoqeria ka te drejte te hape dege dhe filiale, zyra perfaqesimi, ne te gjithë vendin, brenda ose jashte territorit te vendit, gjate aktivitetit te saj.

**Neni 3**

Kohezgjatja e aktivitetit te Shoqerise do te jete e pakufizuar, duke filluar qe prej dates se regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB).

**Neni 4**

Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte si vijon:

- Ndermjetesime e konsulenca ne biznes;
- Ndermjetesim per blerje , shitje, e dhenie me qira te pasurive te paluajtshme;
- Blerje , shitje, e dhenie me qira te pasurive te paluajtshme;
- Import eksport, tregetimi i mallrave;
- Blerje dhe shitje te gjithë artikujve industriale;
- Tregtimi me shumice e pakice i artikujve industrial e ushqimor.

**Neni 5**

Kapitali fillestar i Shoqerise eshte 60 000 (gjashtedhete mije) leke dhe i ndare ne 1 pjese (kuota) me vlere nomiale 60 000 (gjashtedhete mije) leke.

Kapitali zoterohet nga ortaket e shoqerise si me poshte:

-Z. Massimo Sirio, i cili zoteron 1 kuote te Shoqerise ose 60 000 (gjashtedhete mije) leke qe perfaqesojne 100 % te kapitalit te Shoqerise;

Ortaket e Shoqerise mund te vendosin te rrisin kapitalin e Shoqerise ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi dhe me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Shoqerise. Detyrimet e ortakeve te shoqerise kundrejt Shoqerise do te mbulohet vetem me pjesen e kapitalit te paguar prej tyre.



#### **Neni 6**

Shoqeria vepron nen rregjimin e prones private dhe merr persiper vetes te drejtat dhe detyrimet kontraktore dhe jashtekontraktore.

Shoqeria eshte e organizuar ne organet e meposhtme:

-Asambleja e Pergjithshme;

-Administratori;

Kompetencat e Asmblese se Pergjithshme si dhe te administratorit te Shoqerise jane te parashkruara ne Statutin e Shoqerise.

#### **Neni 7**

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike permbajtja e tyre per te tretet, e te gjitha akteve dhe dokumenteve qe jane percaktuar si te tilla nga administratori i shoqerise.

#### **Neni 8**

Mardheniet e punes rregullohen nepermjet kontrates se punes dhe legjislacionit te punes ne fuqi. Shoqeria merr persiper te respektoje rregullat ne fuqi te punesimi dhe te punesuarit jane te detyruar qe ta respektojne Statutin e kesaj Shoqerie dhe rregullat e brendshme te saj. Te punesuarit duhet te pergjigjen per demet qe shkaktojne kesaj Shoqerie me veprimet dhe mosveprimet e tyre.

#### **Neni 9**

Ne rast se Shoqeria do te mbyll aktivitetin e saj per cdo lloj arsye, Asambleja e Jashtezakonshme e Ortakeve te Shoqerise, percakton menyren e likuidimit, emerone nje ose me teper likuidatore dhe pergatit te gjitha dokumentet e nevojshme per c'regjistrimin e saj nga Qendra Kombetare e Biznesit.

#### **Neni 10**

Kontrolli mbi veprimtarine e Shoqerise si dhe gjithe aktivitetin e Shoqerise i besohet nje eksperti kontabel. Ky ekspert do te emerohet dhe qendroje ne detyre sipas parashikimeve qe ben ligji per espartet dhe mund te rizgjidhet. Asambleja e Pergjithshme cakton edhe shperblimin perkates kur nuk ka norma te vecanta ligjore.

#### **Neni 11**


Viti financiar fillon ne 1 Janar dhe mbaron ne 31 dhjetor te secilit vit. Perjashtim, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 dhjetor. Administratori merr masat me qellim hartimin e bilanceve, rezultateve ekonomike te fitimeve apo humbjeve dhe inventarizimin. Pas analizimit te ceshtjeve te mesiperme si dhe shlyerjen e detyrimeve, te ardhurat e tjera do ti kalojne ortakeve te Shoqerise.

#### **Neni 12**

Akti i Themelimit eshte hartuar ne 4 kopje origjinale ne gjuhen shqipe.

Per sa eshte shprehur ne kete Akt Themelimi, i referohemi ligjit 9901, date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" (i ndryshuar).

**ORTAKU I VETEM**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"SIMAS Group" sh.p.k.**



*Emer Mbiemer Nenshkrimi*